


TREGIMET E MIRËSJELLJES



SORKADHJA E VETMUJAR



Engin Nigar



TREGIMET MIRËSJELLES -2

SORKADHJA E VETMUAR

Engin Nigar

• SORKADHJA E VETMUAR	3
• LEPURUSHI ZEMËRMIRË.....	7
• ROSAKU I VOGËL.....	14
• MOLLËKUQJA DHE NJERIU DEMBEL.....	20





SORKADHJA E VETMUAR

Në një pyll të largët jetonte një sorkadhe. Rrinte e vetmuar, sepse nuk pëlqente asnjë shok apo shoqe. Njërën e kishte braktisur se ishte grykëse dhe e pangopur, tjetrin se ishte dinak, ndërsa një tjetër se ishte e shëmtuar. Dhe në fund, ngeli e vetmuar.

Një ditë prej ditëve, doli në pyll për të shëtitur. Rreth e qark shihte shokët e shoqet e saj që luanin dhe qeshnin së bashku. I shikonte, dhe u bë pak ziliqare. Mirëpo ç'të bësh, ajo nuk hiqte dot dorë nga vesi i saj i mospëlqimit. Për këtë arsye, vetëm sa i shihte dhe mërzitej.

Kaluan shumë ditë dhe më në fund, mezi e gjeti një shoqe. Në fillim nuk kishte asnjë problem. Por një





ditë, kur e kishin lënë të takoheshin e të shëtisnin së bashku, shoqja e saj erdhi pak me vonesë. Sorkadhja u zemërua aq shumë me të sa vendosi të mos takohej më.

Përsëri mbeti vetëm. Filloi të mendonte se nuk do të shpëtonte kurrë nga kjo gjendje.


Kaluan ditë të tëra dhe sorkadhja ishte mërzitur shumë prej vetmisë.

“Duhet të gjej sa më shpejt një shoqe, por të jetë pa të meta”, - mendonte ajo me vete.

Po kthehej në shtëpi e dorëzuar dhe e dëshpëruar. Rrugës takoi një kaproll të moshuar. Ai e pyeti:

- Sorkadhe... sikur... të shoh... të dëshpëruar?!

-Po, është e vërtetë, - u përgjigj sorkadhja dhe tek syri i ndriti një lot.



Më pas sorkadhja ia tregoi të gjitha një e nga një. Kaprolli i moshuar, pasi e dëgjoi me vëmendje, i tha:

- Ah, moj bija e ime e shkretë! A ka mik pa të meta? Mjafton të mos kenë qëllime të këqija. Ai që kërkon mik pa të meta, ngelet pa mik dhe detyrohet të jetojë i vetmuar.

Sorkadhja e vetmuar, i dha të drejtë kaprollit të moshuar. Prandaj, puna e parë që bëri, ishte të gjente shoqet, të cilat i kishte braktisur kot dhe t'u kërkonte falje.

Që nga ajo ditë, sorkadhja nuk braktisi më asnjë shoqe pa shkak dhe shpëtoi nga jeta e vetmuar.




LEPURUSHI ZEMËRMIRË

Në një pyll na jetonte një lepurush zemërmirë dhe dashamirës. Vraponte gjithmonë në ndihmë të të tjerëve dhe i ndihmonte nevojtarët me aq sa kishte mundësi.

Një ditë, doli të shëtiste në pyll me qëllimin e mirë për të ndihmuar ndonjë kafshë në nevojë. Ndërkohë që ishte duke vështruar përreth, iu ngul në këmbë një gjemb i madh. Prej dhimbjes së madhe, filloi të përpëlitej në tokë.

Lepurushi, që gjithmonë vraponte në ndihmë të të tjerëve, tani kishte vetë nevojë për ndihmë. Gjemb i ishte ngulur aq thellë, saqë ishte e pamundur ta nxirrte vetë.




Lepurushi zemërmirë priti me orë të tëra për ndihmë. Mirëpo, për fat të keq, nuk i erdhi asnjë ndihmë. Sapo i preu shpresat dhe i dorëzua fatit, pa një arush që po kalonte andej:

- Arush, vëlla, të lutem më ndihmo! Më është ngulur një gjemb i madh në këmbë dhe nuk mund të lëviz fare.


Arushi e dëgjoi ankimin e lepurushit dhe i tha:

- Lepurush, vëlla, tani s'kam kohë të merrem me ty! Pastaj, përse duhet të të ndihmoj?..

Pasi tha këto fjalë, u largua dhe e la vetëm lepurushin. Tani lepurushit iu prenë fare shpresat. Nuk kishte më shpresë për të. Natën e kaloi duke rënkuar nga dhimbja. Në mëngjes, kur lindi dielli, pa sorrën, e cila kishte dalë të gjente ushqim që me rrezet e para të dritës.







- Sorrë, motër! Më është ngulur një gjemb në këmbë. A më ndihmon ta nxjerr! - iu lut lepurushi.

- Më duket se ti je ai lepurushi që para disa ditësh shpëtove zogun tim të vogël, që ra prej folesë. Patjetër që do të të ndihmoj...

Me sqepin e saj e nxori gjembin e madh prej këmbës së lepurushit.


Lepurushi e falënderoi nga zemra sorrën; edhe pse me vështirësi, arriti në shtëpi. Qëndroi shtrirë, derisa iu shërua këmba.

Pas disa ditësh, kur këmba e tij ishte shëruar plotësisht, doli në pyll për të shëtitur. Sigurisht që mendonte të bënte përsëri të mira. Ndërsa, ishte duke shëtitur, pa një gjahtar që kishte drejtuar çiften e tij në një vend. U bë kureshtar dhe u afrua pa e vënë re. Por ç'të shihte! Gjahtari kishte vënë në shënjestër arushin, i cili refuzoi ta ndihmonte pak ditë më parë.

Lepurushi zemërmirë, për një çast nguroi t'i jepte







ndihmë, por pasi u mendua mirë, vendosi ta ndihmonte arushin. Kështu që, duke kaluar si shigjetë mes gjahtarit dhe arushit, tërhoqi gjithë vëmendjen nga vetja e tij.

Arushi përfitoi nga kjo gjendje dhe arriti t'i shpëtonte gjahtarit. Ndërkohë që gjahtari po kërkonte lepurushin, arushi kishte kohë që ia kishte mbathur. Kurse lepurushi u fsheh në një kaçube dhe shpëtoi prej gjahtarit.

Pasi kaluan disa ditë, arushi pa lepurushin në pyll dhe iu afrua kokulur.

- Lepurush vëlla! Më vjen turp prej teje! Kur ti kishe nevojë për ndihmë, unë nuk të ndihmova. E megjithatë, ti më shpëtove jetën. Më mësove se të keqes duhet t'i përgjigjesh me të mirë. Të jam shumë mirënjohës! Prej sot e tutje, do të dalim së bashku në ndihmë të të tjerëve. Lepurushi e pranoi ndjesën e arushit dhe duke i buzëqeshur, e falënderoi atë.




ROSAKU I VOGËL

Në bregun e një liqeni jetonte një familje rosash, e cila përbëhej nga rosa nënë, rosaku baba dhe rosaku i tyre i vogël.

Rosaku, sapo kishte ardhur në jetë, dhe ishte bërë pjesë e asaj familjeje. Prindërit e donin shumë dhe e ruanin nga çdo rrezik. Liqeni ku jetonin, ishte i bukur, por në disa vende të tij kishte dhe kafshë të rrezikshme. Nëna dhe babai e dinin mirë këtë gjë, prandaj nuk e lejonin rosakun e vogël të dilte i vetëm në liqen dhe e paralajmëronin shpesh herë për këtë.








Por një ditë prej ditëve, rosaku i vogël vendosi të dilte për shëtitje në liqen, pa dijeninë e prindërve. Ata ishin ende në gjumë, kur ai u hodh në ujë. Teksa lodronte me valëzat e kaltra, tha me vete: "E përse nuk më japin leje të notoj në liqen?!. Unë notoj shumë mirë! Nuk ka asnjë rrezik për mua!"

Rosaku i vogël nuk e dinte se, më tutje ndodhej një krokodil, i cili kishte dalë dhe po priste të kapte ndonjë gjë për të ngrënë. Notoi deri sa u kënaq dhe vendosi të kthehej në shtëpi. Teksa notonte, pa që valëzat papritur u bënë të egra e kërcënuese. Ktheu kokën pas dhe vuri re se dikush po e ndiqte nga pas. Më në fund e njohu, ishte një krokodil i madh e i frikshëm.




Rosakun e vogël e zuri paniku dhe nuk dinte ç'të bënte. Prej frikës së madhe, filloi të notonte me sa fuqi që kishte.

Ai notonte shpejt, por krokodili notonte më shpejt se ai. Pas një ndjekjeje të shkurtër, krokodili e arriti rosakun e vogël dhe sapo e hapi gojën për ta kollofitur, u godit nga plumbi i një gjahtari, i cili kishte dalë për gjah. Rosaku i vogël arriti të shpëtonte për mrekulli.

Në atë moment, nëna dhe babai i rosakut të vogël u zgjuan nga krisma e armës së gjahtarit. Kur vunë re se rosaku i vogël nuk ishte aty, u shqetësuan shumë. Filluan ta kërkonin gjithandej, me frikën mos i kishte ndodhur ndonjë gjë e keqe.


Më në fund, e gjetën rosakun e vogël në breg të liqenit duke u dridhur nga frika. Menjëherë



nxituan drejt tij dhe e pyetën se çfarë kishte ndodhur. Rosaku i vogël, prej frikës, nuk mundi t'u tregonte asgjë prindërve të tij. Por kur e mori veten, u tregoi të gjitha ato që kishin ndodhur.

- O vogëlushi ynë i dashur! Nëse ne të ndalojmë nga diçka, dije se ajo është për të mirën tënde. Ti nuk na dëgjove dhe për pak desh u bërë ushqim për krokodilin. Po sikur të të kishte ndodhur ndonjë gjë e keqe, çfarë do të bënim ne?! Prandaj, mos e bëj më një gjë të tillë! - i thanë prindërit, të cilët e morën pranë dhe e përqaftuan me dashuri.

Rosaku i vogël dëgjoi me vëmendje këshillat e porositë e prindërve, dhe premtoi se gabime të tilla nuk do të bënte më.





MOLLËKUQJA DHE NJERIU DEMBEL

Në një vend të largët, jetonte një mollëkuqe, e cila fluturonte dhe shëtiste, por herë pas here ulej "të pushonte" mbi njerëzit, sipas dëshirës. Njerëzve u pëlqente shumë kjo gjë...

Një ditë prej ditëve, mollëkuqja kishte dalë për shëtitje përreth vendit ku jetonte. Ajo fluturoi deri atje ku e çuan krahët e saj të vegjël. Më në fund ndjeu lodhje dhe u ul për t'u çlodhur mbi supin e një njeriu. Njeriu e vuri re nuse pashkën dhe u gëzua shumë.

- Miq, e patë? Mbi mua u ul një mollëkuqe. Tashmë do të më kthehet fati. Prandaj s'kam më nevojë të mundohem shumë për të punuar, sepse kjo mollëkuqe pashke do të më sjellë fat...






- Çfarë po thua, o njeri? Unë jam vetëm një mollëkuqe dhe nuk të sjell fat kështu siç mendon ti... Pa punuar e pa u munduar nuk mund të arrish asgjë, - i tha nuse pashka.

Pas një farë kohe, punët e njeriut mbi të cilin ishte ulur mollëkuqja, filluan të mos shkonin mbarë, sepse ai nuk i jepte rëndësinë e duhur asnjë pune.






"Sido që të jetë, kam fatin në anën time dhe punët do të më shkojnë mbarë..." - mendonte ai me vete.

Mirëpo punët nuk shkonin aspak ashtu siç mendonte ai. Njeriu erdhi deri në atë gjendje, sa po humbiste gjithçka.

Pikërisht në këtë kohë, mollëkuqes i erdhi në mendje njeriu, tek i cili ishte ulur para disa ditësh dhe mendoi ta vizitonte sërish. Në fakt nuk besonte, por përsëri u bë kureshtarë në i kishte sjellë fat apo jo. Prandaj dhe e mbajti frymën te ai. Kur ai e pa, u nxeh shumë dhe i bërtiti:

- Mollëkuqe, përse erdhe, apo mos ndoshta për të më shkatërruar plotësisht!?



- Qetësohu pak, o njeri! Nëse nuk punon e përpiqesh, por mbështetesh tek një insekt i vogël, kushedi se çfarë do të të ndodhë tjetër. Mos u bëj dembel, por fillo të punosh!

Njeriu u trondit pak nga fjalët e mollëkuqes, por, megjithatë, i dha të drejtë asaj.

- Pa shikoni këtë insekt! Sa bukur flet... E folura e saj është një mësim i vlefshëm për mua, - tha njeriu dhe i kërkoi ndjesë mollëkuqes për fjalët e rënda që i kishte thënë asaj.

Prej asaj dite, filloi të punonte shumë dhe me ndihmën e Allahut, punët e tij filluan të përmirësoheshin. Mollëkuqes iu bë shumë qejfi...